



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSHËM
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr.649/16

Më
Dana

21-12-2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe sekretaren juridike Drita Ejupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.3084-1/2014 të dt. 04.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini dhe të pandehurit [REDAKTUAR] dhe mbrojtësit të tij me autorizim av.Daut Rudi, me datë 26.10 2017 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 13.11.2017 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], i lindur më [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] e e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] gjendjes se mesme ekonomike, i martuar, Shqiptar, Shtetas, i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDAKTUAR].

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 31.10.2014, në kohë të pacaktuar në fshatin Mirosal, Komuna Ferizaj, duke vepruar në kundërshtim me nenin 2 pika 2.1 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit numër 03L-25, në atë mënyrë që pas një kontrolli të bërë nga Inspektori i Minierave i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka bërë degradimin e mjedisit, si person fizik, pa autorizim dhe pa leje ka shfrytëzuar ilegalisht resurset minerale – rërë kuarcore, në sasi prej 3,004.00 metra kub.

me të cilën kreu veprën penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73, 74 dhe 75 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

GJYKON

- **ME DENIM ME GJOBE NË LARTESI PREJ 500 /pesëqind/ euro, të cilën dënimi është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.**
- Nëse dënimi me gjobë nuk mand të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.

- E dëmtuara Komisioni për Miniera dhe Minerale, rruga "Armend Daci" Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet ne kontest civil.
- Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ €, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP nr.3084-1/2014 të datës 04.07.2016, e ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 26.10.2017 në të cilin Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri [REDAKTUAR], ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: raporti për aktivitetin e jashtëligjshëm minerare nr.prot 10644 i dt.10.11.2014, urdhëresa për ndërprerjen e aktivitetit mineralar dhe sekuestrimin e mjeteve të punës dhe mineraleve, raporti mbi masën e kalkuluar të vëllimit i dt. 18.11.2014, raporti për operimin ilegal i datës 18.12.2014 si dhe dokumentacioni i cili gjendet ne shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KPRK-së, si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, i pandehuri duke vepruar në kundërshtim me nenin 2 pika 2.1 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit numër 03L-25, në atë mënyrë që pas një kontrolli të bërë nga Inspektori i Minierave i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka bërë degradimin e mjedisit, si person fizik, pa autorizim dhe pa leje ka shfrytëzuar ilegalisht resurset minerale – rërë kuarcore, në sasi prej 3,004.00 metra kub.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, se i njëjti është i martuar, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, të pandehurit i vërtetoi dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit dhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

E dëmtuara Komisioni për Miniera dhe Minerale, rruga “Armend Daci” Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, është udhëzuar në kontest civil.


Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni
penal, P.nr.649/16, dt.13.11.2017**

Sekretarja Juridike,
Drita Ujupi

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej
15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të
kësaj gjykate.